



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Sekcioni i Veçantë**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201801636/3**

**Tiranë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2018**

**Lënda:** *Rekomandohet marrja e masave për njohjen e punonjësve të IEVP-ës me të drejtat e punonjësve të Institucionit të Avokatit të Popullit në rastet kur ata kryejnë hetime në vend*

**Drejtuar:** **Drejtorit të IEVP Fushë-Krujë**  
Z. Agron HYSI

**Fushë-Krujë**

**Për Dijeni:** **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**  
Z. Stefan ÇIPA

**Tiranë**

*I nderuar Z. Hysi,*

Në datën 10.08.2018, Institucioni i Avokatit të Popullit ndërmori një hetim në vend për të verifikuar ankesën sipas së cilës i dënuari T. D. ishte keqtrajtuar. Rreth orës 20:45 të kësaj datë, një punonjës i institucionit, i autorizuar për të shqyrtaur ankesa, është paraqitur në IEVP Fushë-Krujë ku fillimisht ka marrë takim me punonjësin e rojës. Punonjësi i institucionit është prezantuar, ka shpjeguar arsyen ardhjes dhe ka këruat të marrë takim me të dënuari T. D. Oficeri i rojës, pas një bisede telefonike me drejtues të IEVP-ës, nuk ka pranuar fillimisht të lejojë punonjësin e Institucionit të Avokatit të Popullit të kryejë detyrën me arsyetimin se ai duhet të paraqitet paradite. Hyrja në IEVP dhe takimi me të dënuarin është lejuar disa minuta më vonë, pasi oficerit të rojes i është bërë e ditur se qëndrimi i tij vinte në kundërshtim me ligjin.

Referuar nenit 19/1 të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.199 "Për Avokatin e Popullit", "Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institacione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

*Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkësë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise.”*

Pra, punonjësit e Institucionit të Avokatit të Popullit nuk kanë kufizim në kohë për të hyrë në IEVP dhe për të marrë takim me të burgosurit. Gjithashtu nuk është e nevojshme që ata të kenë autorizim nga Ministria e Drejtësisë apo nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar prej tij*” si dhe në Nenin 19/1 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”

#### **JU REKOMANDOJME:**

Marrjen e masave për njohjen e punonjësve të IEVP-ës me të drejtat e punonjësve të Institucionit të Avokatit të Popullit në rastet kur ata kryejnë hetime në vend.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, lutemi të vihemë në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

*Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**